



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:008766

Datë: 24.01.2024

Numri i dokumentit: 05230851

**AA.nr.160/2023**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses A... E..., nga Suhareka, kundër të paditurës Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të autorizimit të paditëses, Av. I... S... nga Prishtina, kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.181/2020 të datës 14.12.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.12.2023, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e avokat I... S... nga Prishtina, përfaqësues i autorizuar i paditëses A... E..., nga Suhareka, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.181/2020 i datës 14.12.2022, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.181/2020 të datës 14.12.2022, është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses A... E..., nga Suhareka, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurës Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, me nr.276/19 i datës 18.12.2019.

Kundër aktgjyimit të lartcekur në afatin ligjor ka ushtruar ankesë avokat I... S... nga Prishtina, përfaqësues i autorizuar i paditëses A... E..., nga Suhareka për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimi ankimuar të prishet si i kundërligjshëm ose çështja të kthehet në rivendosje dhe rigjykim.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 par. 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur

me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja ka ushtruar padi për konflikt administrativ në gjykatë me datën 21.01.2020, kundër vendimit të paditurës Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, me nr. 276/19 të datës 18.12.2019, me të cilin i është refuzuar ankesa si e pabazuar e paditëses A... E..., lidhur me faljen e borxhit të akumuluar dhe ka mbetur në fuqi vendimi nr.22197/22 i datës 15.11.2019 i KRU "Hidroregjioni Jugor" .

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditëses paraqitur kundër vendimit të lartcekur të Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin me të cilin kërkesëpadinë e paditëses e refuzon si të pa bazuar. Me arsyetim se Gjykata, në seancën e shqyrtimit kryesor publik ka bërë administrimin e provave dhe atë: Vendimin e dt. 18.12.2019, kopjen e pasaportës së ndjerës A... E..., kërkesën për faljen e borxhit të dt. 29.10.2019, vendimin e dt.15.11.2019, formularin e ankesës së konsumatorit të shërbimit të ujit, procesverbalin e dt.18.12.2019, certifikaten e vdekjes së paditëses, ekstrakti nga gjendja regjistri civil. Gjykata e shkallës së parë konform dispozitave ligjore të nenit 44 par. 1 të LKA-se vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë çështje administrative, dhe thëniet në seancën e shqyrtimit kryesor, ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar. Pala paditëse ka kërkuar faljen e borxhit të vjetër sipas vendimit të Qeverisë me arsyetimin se gjatë kësaj periudhe kur ishte falja e borxheve publike ndodhej jashtë shtetit dhe për këtë të drejtë nuk kishte dijeni. Autoriteti i Rregullatorit për Shërbime të Ujit - Komisioni Këshillues për Konsumator në Prishtinë me vendimin nr.276/19 i dt.18.12.2019 ka refuzuar ankesën e konsumatores dhe ka lënë në fuqi vendimin e KRU nr.22197/ 22 dt. 15.11.2019.

Gjykata e shkallës së parë për të vlerësuar ligjshmërinë aktit të kontestuar Gjykata ju referua dispozitave ligjore respektivisht neni 3 të Ligjit Nr.05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike, për ndryshim Plotësim të Ligjit Nr.05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike. Gjithashtu, Gjykata e shkallës së parë iu referua edhe Udhëzimit Administrativ - Nr. 04/2015 për Procedurat e faljes së borxheve publike i cili përcakton bazën ligjore, procedurat dhe afatet për faljen e borxheve publike që personat fizik dhe juridik kanë ndaj Institucioneve Shtetërore dhe Ndërmarrjeve Publike për periudhën deri më 31 dhjetor 2008, për të përfutur nga lehtësirat tjera për borxhet publike deri më 31 dhjetor 2014, sipas kushteve të përcaktuara në Ligj'. Me provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, përkatësisht vendimi i datës 15.11.2019, të lëshuar nga KRU "Prishtina", rezulton i bazuar fakti që pala paditëse nuk ka shfrytëzuar afatet ligjore për faljen e borxhit. Në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë vlerëson se, e paditura drejtë ka vendosur kur ka refuzuar ankesën e ankueses dhe ka vërtetuar vendimin dt. 15.11.2019. Mbi këto arsye thëniet e paditëses në padi dhe të autorizuarit të saj nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga i padituri.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 9 dhe 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, drejtë ka vendosur kur ka refuzuar kërkesëpadinë paditëses si të pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr

prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se për shkak të nguteise nuk është verifikuar përmbajtja e saktë e kërkesës dhe çështja veprimit erga omnes të afateve ligjore të parashkrimit të kërkesave. Aktvendimi i atakuar përmban arsye kontradiktore me përmbajtjen e provave të administruara. Gjatë shqyrtimit gjyqësor e paditura vetëm verbalisht ka kundërshtuar pretendimet e paditësve, gjykatës nuk i ka ofruar asnjë prove materiale për të mbështetur deklaratimet e saja. Po ashtu paditësja ka kontestuar edhe mënyrën e krijimit të borxhit të faturuar, ku kjo çështje fare nuk sqarohet as qe merret parasysht nga gjykata, sikurse të mos ishte paraqitur fare, pra gjykata njëanshëm vlerëson provat. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditëses ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditëses në padi janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe gjykata e shkallës së parë, se paditësja si konsumatorë nuk i ka shfrytëzuar afatet ligjore për faljen e borxhit. Pra, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka gjetur se organi i paditur ka analizuar faktet e rastit, dëshmitë dhe argumentet e paraqitura nga palët, andaj, pranë një gjendje të tillë faktike kolegji i kësaj gjykate konsideron se aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore se aktgjykimi i ankimuar është i përfshire me shkelje thelbësore të dispozitave të procedure kontestimore nga neni 182.1 pika k) n) dhe o) dhe me nenin 160 par.1 nenpar. 3,4 dhe 5 të LPK-së, qe si pasoj e shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedure kontestimore dhe vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike është bere aplikim i gabuar i të drejtës materiale. Ky kolegji nuk e aprovoj, ngase konsideron se këto pretendime ankimore janë të pa qëndrueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa, nga arsyet e lartcekura të theksuara edhe nga gjykata e shkallës së parë, dhe si të tilla nuk kanë ndikim në konstatimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo që ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se edhe e drejta materiale, është aplikuar drejtë dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Duke marrë parasysht se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadiisë së paditëses dhe lënies në fuqi të vendimit të lartpërmendur, e pasi që me pretendimet tjera ankimore një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e përfaqësuesit të autorizimit të paditëses, Av. I... S... nga Prishtina, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
AA.nr.160/2023 me datë 28.12.2023

**Kryetari i kolegjit,**  
Ramiz Kuqi